VENDIM
Nr.663, datë 18.12.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO EMANUEL""

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio telelvizivë" dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e subjektit radiofonik vendor privat "Radio Emanuel", për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 14.1.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)